

20250711517

МИНИСТЕРСТВО ЗА ЕКОНОМИЈА И ТРУД

Në bazë të nenit 15-a paragrafit (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorëve (*) (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 236/22, 3/25 dhe 49/25), Ministri i Ekonomisë dhe Punës, miratoi

R R E G U L L O R E N PËR MËNYRËN E PUBLIKIMIT TË ÇMIMEVE TË MALLRAVE DHE TË DHËNAT QË DUHET TË PUBLIKOHEN NGA ANA E TREGTARIT TË VOGËL, TË MESËM DHE TË MADH, I CILI KRYEN TREGTI ME PAKICË

Neni 1

Me këtë rregullore përshkruhet mënyra e publikimit të çmimeve të mallrave dhe të dhënave që duhet të publikohen nga ana e tregtarit të vogël, të mesëm dhe të madh, i cili kryen tregti me pakicë.

Neni 2

(1) Tregtari i vogël, i mesëm dhe i madh që kryen veprimtari tregtare me pakicë në përputhje me Klasifikimin Kombëtar të Veprimtarive (në tekstin e mëtejme: tregtari) i publikon çmimet e mallrave që plason në treg në faqen e tij të internetit në mënyrë të qartë dhe të qasshme, përmes një pjese të veçantë të ueb-faqes së tregtarit të dedikuar për çmimet (Çmimore).

(2) Çmimet e publikuara duhet të jenë të disponueshme pa pasur nevojë për regjistrim ose hyrje shtesë.

(3) Çmimet e mallrave (çmimi aktual i shitjes, çmimi për njësi, çmimi promocional ose me zbritje) për secilën pikë të shitjes të tregtarit publikohen në ueb - faqen e internetit në përputhje me me paragrafin (1) të këtij neni dhe përmbajnë të dhënat e përcaktuara në Shtojcë, e cila është pjesë përbërëse e kësaj rregullore.

(4) Nëse nga ana e tregtarit ofrohen çmime promocionale ose me zbritje, çmimi i rregullt, në ueb - faqen e internetit të tregtarit, duhet të shënjohe çmimi i rregullt, përqindja dhe shuma e reduktimit, si dhe kohëzgjatja e promocionit ose zbritjes.

Neni 3

(1) Tregtarët duhet të përditësojnë çmimet e mallrave në baza ditore, respektivisht çdo ditë pune deri në orën 10:00.

(2) Në rast të gabimit teknik padashje në përditësiin e çmimeve dhe mallrave, tregtari duhet ta korrigjojë gabimin në afat prej 24 orëve.

Neni 4

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme, pas publikimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Nr.23-1883/1
28.3.2025
Shkup

Ministër i Ekonomisë dhe Punës,
Besar Durmishi, d.v.

Shtojcë

Paraqitja tabelare e çmimeve të mallrave (çmimi aktual i shitjes, çmimi për njësi, çmimi promocional ose me zbritje) për çdo objekt shitjeje të tregtar

Data dhe Koha e Përditësimit të Fundit të Çmimit

Emri i mallit - produktit (marka, tregtare, modeli, etj.)	Çmimi i shitjes (me TVSH)	Çmimi i njësisë (sipas kg, litër, metër etj.)	Përshkrimi i mallit	Qasja në objektin e shitjes	Çmimi i rregullt (me TVSH)	Çmimi promocional ose me zbritje		
						Çmimi me zbritje (me TVSH)	Lloji i stimulit të shitjeve (çmimi promocional, lojaliteti, oferta e paketës, zbritja sezonale, etj.)	Kohëzgjatja e promovionit ose zbritjes